



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE KOORDINIMIT

KODI 43

**SHPLLJE PËR NËPUNËS CIVILË LËVIZJE PARALELE, DHE
NGRITJE NË DETYRË NË KATEGORINË E MESME DHE TË ULËT
DREJTUESE**

**PËRGJEGJËS NË SEKTORIN E STATISTIKAVE TË R&D, INOVACIONIT,
TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE TRANSPORTIT NË DREJTORINË E
STATISTIKAVE EKONOMIKE**

Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Koordinimit në Institutin e Statistikave shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për pozicionin:

43 – Përgjegjës në Sektorin e Statistikave të R&D, Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Transportit në Drejtorinë e Statistikave Ekonomike, Kategoria e pagës III-a.

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për LËVIZJE PARALELE: **06 Maj 2019**

Afati për dorëzimin e dokumentave për NGRITJE NË DETYRË: **10 Maj 2019**

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

Përgjegjësi siguron që tregusit e prodhuar na sektori (tregusit e teknologjisë së informacionit dhe komunikacionit, treguesit kërkimit shkencor dhe zhvillimit, treguesit e inovacionit si Përgjegjës Sektori i Statistikave të Kërkimit Shkencor dhe Zhvillimit, Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Transportit, përgjigjet para drejtorit të statistikave ekonomike për treguesit që llogarit dhe publikon si shpenzimet e Kërkimit shkencor, shpenzimet për aktivitetin e Inovacionit, stafin e angazhuar në këto aktivitete, Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE KOORDINIMIT

Komunikimit në ndërmarrje. Përgjegjësi siguron që treguesit e prodhuar nga sektori (treguesit e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, treguesit kërkimit shkencor dhe zhvillimit, treguesit e inovacionit si edhe treguesit e transportit (administrativë dhe nga vrojtimi) janë llogaritur sipas Programit Kombëtar Statistikor dhe kanë respektuar metodologjitë sipas standarteve evropiane, brenda afateve të përcaktuara. Gjithashtu, organizon, drejton, monitoron, vlerëson punën e punonjësve në varësi. Të propozojë dhe iniciojë aktivitete të reja statistikore në përputhje edhe me kërkesat e Eurostat, të iniciojë pjesëmarrjen e stafit në trajnime për ngritjen profesionale të tyre.

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (III-a/III-a/1)
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shume mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor apo Master Profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike”, në fushën Ekonomike /Statistike.
- b- Edhe diploma e nivelit Bachelor të jetë në të njëjtën fushë.
- c- Te ketë të paktën 3 vjet eksperiencë pune në profesion.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Kërkesë për pozicionin që aplikon
- b- Jetëshkrim i aplikantit (modeli europass);
- c- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE KOORDINIMIT

- h- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
 - i- Vërtetimin nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
 - j- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në INSTAT brenda **datës 6 Maj 2019**.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **8 Maj 2019**, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Koordinimit do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Institutit të Statistikave dhe stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Koordinimit në Institutin e Statistikave, (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

1. Ligji nr 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” (http://www.instat.gov.al/media/3973/ligj-nr-17-dt-542018_per-statistikat-zyrtare.pdf);
2. Ligjin nr.152/2013, “Për Nëpunësit Civil”;
3. Programi Statistikave Zyrtare 2017- 2021 (<http://www.instat.gov.al/media/3594/psz-2017-2021.pdf>)
4. Njohuri mbi Manualin e Frascatit (https://read.oecd-ilibrary.org/science-and-technology/frascati-manual-2015_9789264239012-en#page1) dhe Manualin e Oslos (https://read.oecd-ilibrary.org/science-and-technology/frascati-manual-2015_9789264239012-en#page1)
5. Njohuri mbi statistikën e Transportit e prodhuara nga INSTAT (<http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%3%ABrbimet/transporti-dhe-aksidentet/>)
6. Njohuri mbi statistikën mbi Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit të prodhuara nga INSTAT (<http://www.instat.gov.al/al/temat/shkenc%3%AB-teknologji-dhe-shoq%3%ABria-dixhitale/informacioni-dhe-teknologjit%3%AB-e-komunikimit/>)

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE KOORDINIMIT

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe për vlerësimet e rezultateve individuale në punë. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;

b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;

c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Koordinimit në Institutin e Statistikave do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen e internetit të Institutit të Statistikave dhe standat e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

2. NGRITJA NË DETYRË

Në rast se pozicioni i cituar më sipër, nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, vazhdon procedura e ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen e internetit të INSTAT dhe në portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, si dhe standat e informimit të publikut duke filluar nga data **20 Maj 2019**.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE KOORDINIMIT

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROÇEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati (Nëpunës Civil) në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në kategorinë III-b; IV-a; IV-b
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vertetuar me një dokument nga institucioni);
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” apo Master Profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike në në fushën Ekonomike/ Statistike
- b- Edhe diploma e nivelit Bachelor të jetë në të njëjtën fushë.
- c- Të ketë të paktën 3 vjet eksperiencë pune në profesion.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët (nëpunës civilë) duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Kërkesë për pozicionin që aplikon.
- b- Jetëshkrim i aplikantit (modeli europass)
- c- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- h- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- i- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- j- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në Institutin e Statistikave brënda datës **10 Maj 2019**.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **20 Maj 2019**, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Koordinimit në Institutin e Statistikave do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të INSTAT dhe stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE KOORDINIMIT

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim për njohuritë mbi dokumentet e listuara në pikën 1.4

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Koordinimit në Institutin e Statistikave do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail). Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Koordinimit do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe stendat e informimit të publikut.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në Shërbim Civil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e internetit të Institutit të Statistikave , për fazat e mëtejshme të kësaj procedure duke filluar nga data **20 Maj 2019**.